



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

KRYETARI

Nr. 747 / Prot.

Shkodër, më 23/12 / 2024

Vendim

Nr. 26 , Datë 20/12 / 2024

"Mbi miratimin e Buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2025-2027"

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 20.12.2024, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, bazuar në nenin 9 pika 1.3, germa "C", neni 14,34,38,40,41,77 germa 'dh' të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 6 të Ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Kreu III, neni 21, kreu IV, kreu VII, nenet 39-40 të Ligjit nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes vendore", Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar, Udhëzimet e Ministrisë së Financave nr.23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të NJQV", i ndryshuar, Udhëzimin Nr.3, datë 28.02.2024 Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2025-2027", Udhëzimit Plotësues nr.8, datë 09.07.2024 "Për përgatitjen e PBA Vendor 2025-2027", Udhëzimin nr. 9 date 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin Plotësues nr.1, datë 24.01.2024 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024", Ligjin Nr. ___/2024 "Per Buxhetin e Vitit 2025", Bazuar dhe në Sistemin e Menaxhimit të Buxhetit Vendor, Relacionin e Buxhetit të vitit 2025, bazuar në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, pas relatimit nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe pas diskutimit nga anëtarët e keshillit, u kalua në procesin e votimit ku u *miratua* me *17 Vota Pro, 0 Vota Kundër dhe 0 Vota Abstenim*;

VENDOSI;

ë miratojë Buxhetin e Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025 si dhe Programin Buxhetor Afatmesem 2025-2027 sipas Tabelave Nr.1 dhe 2 dhe raporteve të nxjerra nga Sistemi i Menaxhimit të Buxhetit Vendor, si më poshtë:

- a) Buxheti I vitit 2025 sipas Tab.nr.1
 - b) BV1- Buxheti I NJVQV sipas Programeve dhe Njesise Shpenzuese
 - c) BV2- Tavanet e PBA sipas Programeve
 - d) BV3- Parashikimi I te ardhurave
 - e) Plani I te ardhurave sipas tabelës nr.2
 - f) BV4- Shpenzimet sipas Klasifikimit Ekonomik
 - g) BV5- Numri I punonjësve sipas programit të NJVQV
 - h) BV6- Shpenzimet sipas Klasifikimeve Buxhetore
 - i) BV7- Lista e projekteve të investimeve të NJVQV
 - j) BV15- Plani I Arkes
2. Fondet e përdorura në fund të vitit 2024, me burim financimi transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta, do të jenë pjesë e buxhetit të vitit 2025 dhe do të rishpërndahen pjesërisht sipas paragrafit IV, të relacionit të Buxhetit të vitit 2025.
 3. Është në kompetencë të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër;
 - Rishpërndarja e Projekteve të Investimeve , brenda të njëjtit Program.
 - Rishpërndarja ndërmjet zerave të shpenzimeve korrente, brenda të njëjtit Program.
 4. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari I Këshillit të Qarkut Shkodër.
 5. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

